

DEKRET
Nr. 445, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Ernesto Madeo**

“Në vlerësim të kontributit të jashtëzakonshëm në ruajtjen e identitetit, gjuhës dhe kulturës arbëreshe, si dhe për rolin thelbësor në forcimin e lidhjeve kulturore, institucionale dhe shoqërore midis komunitetit arbëresh të Kalabrisë dhe Shqipërisë. Në nderim të përpjekjeve të vyera për krijimin e urave të bashkëpunimit në fushën e historisë, kulturës dhe zhvillimit komunitar, duke bërë që zëri, memoria dhe trashëgimia arbëreshe të mbeten të gjalla dhe të pandara nga atdheu shqiptar”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj